



# DEZINFORMIMI GJATË RAPORTIMEVE NË KOHË LUFTE


(SHQIPËRI)



FAKE NEWS  
FAKE NEWS  
FAKE NEWS  
FAKE NEWS  
FAKE NEWS  
FAKE NEWS  
FAKE NEWS  
FAKE NEWS  
FAKE NEWS



|              |   |    |
|--------------|---|----|
| <b>I.</b>    | Hyrje .....   | 4  |
| <b>II.</b>   | Metodologjia .....  | 6  |
| <b>III.</b>  | Narrativat kryesore .....   | 8  |
| <b>III.1</b> | Narrativa dezinformuese për justifikimin e pushtimit të Rusisë në Ukrainë ..... | 8  |
| <b>III.2</b> | Përfshirja e NATO-s/Shteteve të Bashkuara në Ukrainë .....                      | 9  |
| <b>III.3</b> | Rusia do të fillojë Luftën e Tretë Botërore/Luftën Bërthamore .....             | 9  |
| <b>III.4</b> | Luftërat shërbyese nga palë të treta në Ballkanin Perëndimor.....               | 10 |
| <b>IV.</b>   | Rastet studimore.....   | 11 |
|              | <b>Rasti studimor 1:</b>  |    |
|              | Mercenarë shqiptarë në Ukrainë .....  | 11 |
|              | <b>Rasti studimor 2:</b>  |    |
|              | Lufta midis Kosovës dhe Serbisë.....  | 12 |
|              | <b>Rasti studimor 3:</b>  |    |
|              | Zelenski paralajmëron luftë në ballkanin perëndimor.....                        | 16 |
|              | <b>Rasti studimor 4:</b>  |    |
|              | NATO ka trupa në Ukrainë.....   | 19 |
|              | <b>Rasti studimor 5:</b>  |    |
|              | Raporti i Inteligjencës Amerikane parashikon luftë në Ballkan .....             | 20 |
|              | Bibliografia .....  | 23 |



Propaganda ka luajtur gjithmonë një rol kyç në zhvillimin e luftës, pasi subjektet shtetërore dhe jo-shtetërore të përfshira në të kërkojnë të krijojnë mbështetje për të justifikuar veprimet e tyre, për t'i penguar të tjerët të përfshihen në konflikt dhe për ta mbajtur popullsinë nën kontroll. Lufta bashkëkohore ka një dimension të komplikuar shtesë: jo vetëm që transmetohet në televizion, por ndahet dhe përjetohet online në kohë reale gjithnjë e më shumë. Në momente konflikti dhe pasigurie, miliona njerëz kërkojnë informacion në internet (dhe gjithnjë e më shumë në media sociale). Nevoja për lajme dhe informacion në momente të caktuara shpesh përplasit me aftësinë e gazetarëve dhe mediave të besueshme me reputacion, të cilët kanë nevojë për kohë dhe përpjekje për të verifikuar faktet me shpejtësi dhe në situata të paparashikueshme. Ky tension midis dëshirës për informacion të menjëhershëm dhe realitetit të nevojshëm për të dhënë një informacion të saktë ka qenë veçoria karakteristike e peizazhit mediatik të sotëm, e theksuar veçanërisht në momente konflikti dhe në zonat e luftës. Veçori të cilën aktorët keqdashës e shfrytëzojnë për të manipuluar situatën dhe narrativat në interesin e tyre.

Kemi dëshmuar në kohë reale se si dezinformimi mund të ndikojë perceptimet ndaj luftës dhe konflikteve me pushtimin e Rusisë në Ukrainë

në shkurt të vitit 2022. Fillimisht, me aneksimin e Krimesë në vitin 2014, Rusia ka përdorur instrumentet e saj mediatike për të përhapur dezinformim me qëllim prezantimin e veprimeve të kryera në Ukrainë në favor të saj dhe për të ulur besimin te mediat dhe qeveritë perëndimore. Rusia, përmes dezinformimit të saj, ka synuar të arrijë tek fushatat zgjedhore në të gjithë botën dhe tani po përpiqet të formësojë opinionin publik mbi arsyet se pse e pushtoi Ukrainën.<sup>1</sup> NATO ka përcaktuar narrativat e dezinformimit që Rusia po përdor për të justifikuar veprimet e saj, duke përfshirë pretendimet se NATO është në luftë me Rusinë, se Aleanca i kishte premtuar Rusisë se nuk do të zgjerohej pas Luftës së Ftohtë dhe që rrjedhimisht nuk do ta rrethonte territorin e saj, si dhe që NATO dhe lëvizjet e saj janë agresive dhe kërcënuese për Rusinë.<sup>2</sup> Shumë nga këto narrativa kanë arritur në mediat shqiptare, siç do t'i shpjegojmë më poshtë.

Lidhjet kulturore, politike dhe sociale të Ballkanit Perëndimor me Rusinë e kanë bërë rajonin terren pjellor për përhapjen e dezinformimit rus. Siç argumentohet në raportin e Qendrës së Komunikimeve Strategjike të NATO-s, "Rusia e sheh Ballkanin Perëndimor si një mundësi për të nënvlerësuar BE-në dhe NATO-n duke përdorur pikat e dobëta të vendeve të këtij rajoni."<sup>3</sup> Në përhapjen e dezinformimit ndaj BE-së dhe NATO-s, Rusia përpiqet të dobësojë besimin

<sup>1</sup> OECD, "Dezinformimi dhe lufta e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës: Kërcënimet dhe masat e qeverisjes." <https://www.oecd.org/ukraine-hub/policy-responses/disinformation-and-russia-s-war-of-aggression-against-ukraine-37186bde/>.

<sup>2</sup> NATO, "Rregullimi i të vërtetës: Përgënjeshtërimi i dezinformimit rus në lidhje me NATO." <https://www.nato.int/cps/en/natohq/115204.htm>.

<sup>3</sup> Qendra e Komunikimeve Strategjike të NATO-s, "Ndikimi i Rusisë në mjedisin informativ në Ballkanin Perëndimor." [https://stratcomcoe.org/pdfs/?file=/publications/download/russias\\_footprint\\_in\\_wb\\_executive\\_summary\\_30-04\\_v2-2.pdf?zoom=page-fit](https://stratcomcoe.org/pdfs/?file=/publications/download/russias_footprint_in_wb_executive_summary_30-04_v2-2.pdf?zoom=page-fit).

në këto institucione dhe të paralizojë zgjerimin e tyre. Lufta në Ukrainë i ka dhënë Rusisë mundësinë që këto narrativa të përhapen, duke përdorur pasigurinë dhe dëshirën e publikut për informacion.

Shpeshherë Shqipëria është parë si një nga vendet më pak të prekura nga propaganda ruse. Në përgjithësi, anketat për vulnerabilitetin e vendit ndaj ndikimit të dëmshëm të huaj në media kanë nxjerrë si konkluzion se dezinformimi në Shqipëri është një çështje e brendshme.<sup>4</sup> Megjithatë, lufta në Ukrainë ka treguar se Shqipëria është ende e ekspozuar ndaj propagandës ruse dhe nuk është immune kundër saj. Portale dhe faqe të caktuara në Facebook publikojnë rregullisht propagandën dhe dezinformimin rus, ndërsa media të tjera përhapin dezinformim duke raportuar deklarata të politikanëve dhe mediave ruse pa dhënë kontekst, ose pa i hedhur poshtë pretendimet. Raporti i fundit i Balkan Investigative Network ka zbuluar se 88 narrativat e dezinformimit të identifikuara nga baza e të dhënave EUvsDisinfo u paraqitën në median shqiptare, rreth 22% e bazës më të madhe të të dhënave. Studiuesit arritën të gjejnë rreth 377 artikuj në median shqiptare që përmbanin dezinformim rus.<sup>5</sup> Këto rezultate konfirmojnë studimet e dy viteve të fundit të Fakteje-s mbi narrativat e përhapura në median shqiptare, veçanërisht ato që lidhen me mbulimin e luftës në Ukrainë.

Përveç dezinformimit rreth luftës në Ukrainë, Shqipëria është veçanërisht e ndjeshme ndaj dezinformimit për konfliktin midis Serbisë dhe Kosovës, sidomos ndaj narrativave që parashikojnë një luftë midis dy vendeve ose që

presin një tjetër luftë në Ballkanin Perëndimor.<sup>6</sup> Sa herë që tensionet përshkallëzohen në veri të Kosovës ose përpjekjet për dialog ngecin, mediat shqiptare raportojnë frikën për një luftë të re, duke ngritur pretendime mbi ushtrinë serbe në kufi. Frikërat ushqehen më tej nga deklaratat e politikanëve që ndezin zjarrin e një lufte të mundshme, të cilat mediat shqiptare i ripublikojnë pa konfirmim ose pa kontekst. Po ashtu, interesat strategjike të Rusisë në Ballkanin Perëndimor nënkuptojnë interesin e vendit ndaj përkeqësimit të konflikteve lokale për rritjen e paqëndrueshmërisë ndërsa narrativat që i shërbejnë synimeve të Rusisë vetëm përkeqësojnë konfliktet etnike në një cikël që vetëmbahet.


Raportimet për luftën dhe konfliktin kërkon ndërgjegjësim të rritur për mënyrën se si aktorët, si shtetërorë ashtu edhe jo-shtetërorë, e përdorin dezinformimin dhe propagandën për të krijuar opinionin publik. Saktësia është e domosdoshme kur bëhet fjalë për situata me rëndësi, sidomos në kontekstin e konflikteve rajonale në Ballkanin Perëndimor, që mund të përhapin konflikte etnike dhe të përmbushin synimet e vendeve si Rusia. Narrativat mund të ndikojnë opinionin publik, të ulin besimin te proceset demokratike, si dhe te BE-ja e NATO. Siç tregon raporti më poshtë, ky është një realitet që po ndodh tashmë në peizazhin mediatik shqiptar, veçanërisht në lidhje me luftën në Ukrainë dhe konfliktin midis Serbisë dhe Kosovës. Përpjekjet për t'i kundërpërgjigjur këtij realiteti duhet të përfshijnë gazetarinë e përgjegjshme që bazohet në kërkime të thella dhe përpjekje për verifikim të fakteve.

4. Parlamenti Evropian, Hartëzimi i lajmeve të rreme dhe dezinformimi në Ballkanin Perëndimor dhe identifikimi i mënyrave të luftimit efektiv të tyre (2021), [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO\\_STU\(2020\)653621\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU(2020)653621_EN.pdf).

5. BIRN, "Narrativat e Dezinformimit të sponsorizuara nga shteti rus në Shqipëri." <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2023/07/Russian-state-sponsored-disinformation-narratives-in-Albania.pdf>.

6. Agon Maliqi, "Lufta e informacionit rus në Ballkan: Si instrumentalizohen identiteti dhe feja në konfliktin Kosovë-Serbi," Berkley Center në Georgetown, <https://berkeleycenter.georgetown.edu/posts/russian-information-warfare-in-the-balkans-how-identity-and-religion-are-instrumentalized-in-the-kosovo-serbia-dispute>.

## II. METODOLOGJIA



Raporti synon të kuptojë narrativat e përdorura nga mediat shqiptare në mbulimin e situatave të luftës dhe konfliktit dhe mënyrat e përhapjes së dezinformimit. Ne ishim veçanërisht të interesuar të kuptonim se si ndikimet dashakeqëse të huaja krijojnë narrativat e luftës në median shqiptare dhe sa të mëdha janë këto ndikime. Konkretisht, kemi analizuar ndikimin e fushatave dezinformuese të Rusisë në lidhje me luftën në Ukrainë, por edhe përpjekjet e Rusisë për të destabilizuar Ballkanin Perëndimor përmes agjentëve të saj. Kemi vepruar me bindjen se Rusia ka interesa strategjike në Ballkanin Perëndimor dhe lidhje të forta kulturore, politike dhe sociale me disa vende në rajon që i mundësojnë asaj të të përhapë narrativat e saj rreth luftës në Ukrainë. Në këtë kontekst, kemi dashur të shohim se sa të ndjeshme janë mediat shqiptare ndaj ndikimeve ruse dhe cilat prej tyre kanë lidhje direkte me Rusinë.

Metodologjia bazohet në një rishikim cilësor të gjithanshëm të raportimit të mediave shqiptare mbi luftën dhe konfliktet që nga 24 shkurti 2022, kur Rusia pushtoi Ukrainën. Sa i përket luftës në Ukrainë, kemi hetuar edhe mënyrën se si përfaqësuesit Rusë në Ballkanin Perëndimor (sidomos qeveria aktuale serbe) e kanë shfrytëzuar këtë rast për të nxitur konfliktin në rajon dhe se si mediat shqiptare kanë reaguar ndaj këtyre provokimeve të tilla. Për kryerjen e analizës, jemi bazuar në punën e Fakte për dezinformimin në Ballkanin Perëndimor dhe në Shqipëri, duke

u përqendruar te ndikimet dashakeqëse të huaja dhe përhapjen e tyre në mediat shqiptare, përfshirë agjenci lajmesh, tabloide dhe llogari në rrjetet sociale.

Për gjatë dy viteve të fundit, kemi mbajtur një bazë të gjerë të dhënash mbi narrativat e dezinformimit të përhapura në mediat shqiptare në lidhje me luftën në Ukrainë, ndjesitë anti-NATO dhe anti-BE, konfliktin Kosovë-Serbi dhe çështje të tjera të ngjashme (si lëvizja për shkëputje e Bosnjës, konfliktet etnike në Maqedoninë e Veriut dhe Mal të Zi, si dhe lëvizjet më të mëdha nacionaliste në rajon). Për mbajtjen e kësaj bazë të dhënash, specialistët tanë të monitorimit kanë shqyrtuar përmbajtjen e gjeneruar nga 20 media shqiptare, duke përfshirë kanalet kryesore të lajmeve, portale me ndikim të konsiderueshëm dhe tabloidet më të vogla. Gjithashtu, kemi zbatuar metodën e “kërkimit nga ana e kundërt”, ku kemi hetuar përhapjen e çdo pretendimi, artikulli apo narrative përtej këtyre 20 portaleve, duke u përpjekur të gjejmë si burimin shqiptar, ashtu edhe atë të huaj. Për këtë aspekt të analizës sonë, si dhe për të rikonfirmuar gjetjet tona, jemi mbështetur edhe te baza e të dhënave EUvsDisinfo, e cila “identifikon, përmbledh dhe ekspozon rastet e dezinformimit që bëhen nga mediat pro-Kremlinit që përhapen në BE dhe vendet e partneritetit lindor”.<sup>7</sup>

Baza jonë e të dhënave ka patur mesatarisht 75 artikuj në muaj me dezinformim lidhur me çështjet e lartpërmendura, megjithatë artikujt

<sup>7</sup>. Baza e të dhënave e EUvsDisinfo, “Rreth,” <https://euvsdisinfo.eu/about/>.


përmblihdeshin rreth një grupi bazë prej 5-7 narrativash, pasi shumë media kopjonin njëra-tjetrën dhe përhapnin pretendime të njëjta, shpesh herë fjalë për fjalë. Duke shqyrtuar këtë bazë të gjerë të dhënash, kemi arritur të bëjmë një pasqyrim të përgjithshëm të mënyrës se si mediat shqiptare i kanë trajtuar pyetjet e lidhura me luftën dhe konfliktin në rajon dhe më tej, rastet e dezinformimit dhe përhapjen e propagandës ruse në mediat shqiptare. Seksioni i narrativave kryesore përmban një pasqyrë të shkurtër të narrativave më të zakonshme rreth luftës, me lidhjet e artikujve përkatës.

Seksioni i Rasteve studimore bazohet po ashtu te puna e Faktoje-s për hedhjen poshtë ose përgënjeshttrimin e narrativave të dezinformimit të përhapura në median shqiptare nga subjektet ruse dhe përfaqësuesit e tyre. Gjatë dy viteve të fundit, kemi publikuar më shumë se 150 artikuj që hedhin poshtë dhe përgënjeshtrojnë dezinformime që vijnë nga Rusia dhe më tej, duke

gjurmuar burimet dhe përhapjen e tyre në median shqiptare. Pas shqyrtimit të bazës së të dhënave të Faktoje-s për përgënjeshttrimet, kemi zgjedhur pesë raste që përputhen me narrativat më të zakonshme të luftës që i kemi identifikuar gjatë analizës sonë të gjenerimit mediatik shqiptar në dy vitet e fundit. Ne përmbledhim pretendimet dhe zbërthejmë narrativën që ata përhapin dhe tregojmë si është përhapur në median shqiptare.

Siç e theksuam në hyrje të raportit, roli i dezinformimit në kohërat e luftës është rritur ndjeshëm me internetin dhe shtimin e mediave sociale, si dhe është përkeqësuar nga rritja e ndikimit të Rusisë. Për ta vendosur situatën e Shqipërisë në kontekstin e çështjeve globale dhe rajonale, kemi bërë edhe një analizë të plotë dhe të thelluar të literaturës mbi pyetjet e lidhura me luftën dhe dezinformimin, si dhe çështjen e dezinformimit rus. Bibliografia jonë përmban tekstet kyçe mbi këtë temë.

### III. NARRATIVAT KRYESORE



#### III.1 Narrativa dezinformuese për justifikimin e pushtimit të Rosisë në Ukrainë

Edhe para se Rusia të nisë pushtimin e saj në Ukrainë në vitin 2022, Kremli i kishte vendosur themelet e fushatës propagandistike për justifikimin e luftës. Fushata kanë vazhduar përgjatë dy viteve të fundit dhe narrativat e tyre kanë qarkulluar edhe në Shqipëri. Gjatë kësaj kohe, mediat shqiptare kanë ripublikuar deklarata të politikanëve rusë, qeverisë ruse, si dhe të mediave të mbështetura nga Rusia si Sputnik. Një nga përpjekjet më të qarta për manipulimin e perceptimeve të luftës është etiketimi i saj si “operacion special”, që shumë mediat shqiptare e kanë riprodhuar. Për shembull, një portal ka publikuar një deklaratë të Putin me titullin: “Forcimi i ushtrisë dhe ‘operacioni special në Ukrainë’ do të jenë prioritet, tha Putin në fjalën e tij të fitores.”<sup>8</sup>

Pretendimet për justifikimin e pushtimit të Rosisë në Ukrainë kanë marrë forma të ndryshme. Në përgjithësi, Rusia ka tentuar të krijojë një aks të ri nëpërmjet të cilit ajo prezantohet si fuqia e mirë, ndërsa Perëndimi dhe NATO si fuqia e keqe. Në këtë kontekst, një nga narrativat që ajo ka shfrytëzuar ishte se pushtimi i Ukrainës erdhi si

shkak për shpëtimin e ukrainasve që flasin rasisht nga ‘neo-nazistët’. Rusia pretendon se një grusht shteti në vitin 2014 solli në pushtet simpatizantë të nazizmit në Ukrainë dhe e bëri vendin më të afërt me Perëndimin. Rusia ka përdorur historinë e saj në Luftën e Dytë Botërore për ta paraqitur pushtimin si një akt lirie nga nazistët.<sup>9</sup> Këto narrativa janë përhapur edhe nga mediat shqiptare, të cilat kanë publikuar artikuj me tituj që përputhen me narrativën ruse dhe përhapin dezinformim: “Denazifikimi sipas Moskës: Do të duhen 25 vjet, punë e detyruar, të zhduket emri Ukrainë.”<sup>10</sup>

Rusia ka pretenduar gjithashtu se e ka pushtuar Ukrainën për ta mbrojtur veten nga zgjerimi i Perëndimit, i cili paraqitet si kërcënim jetik për Rusinë— ndonëse do të ishte më e qartë të thuhej se perëndimi është kërcënim për ambicjet perandorake të Rosisë. Pas intensifikimit të afrimit të Ukrainës me Perëndimin, duke përfshirë edhe interesin për anëtarësim në NATO, Putin dhe qeveria e tij i kanë prezantuar këto ndryshime gjeopolitike si kërcënime ekzistenciale për Rusinë. Putin pretendon se Perëndimi dëshiron ta copëtojë Rusinë në gjendjen aktuale të saj, pa konsideruar ndryshime apo zhvillime të tjera.<sup>11</sup> Në këtë kontekst, Kremli ka pretenduar se SHBA-ja

<sup>8</sup> N.D., “Forcimi i ushtrisë dhe “operacioni special në Ukrainë” do të jenë prioritet, tha Putin në fjalimin e tij të fitores, Portalb, March 18, 2024. <https://portalb.mk/forcimi-i-ushtrise-dhe-operacioni-special-ne-ukraine-do-te-jene-prioritete-tha-putin-ne-fjalimin-e-tij-te-fitores/>.

<sup>9</sup> Jeffrey Veidlinger, “Pretendimi i Putin për të pastruar Ukrainën nga nazistët është absurd sidomos në dritën e historisë së saj,” The Conversation, 26 shkurt 2022. <https://theconversation.com/putins-claim-to-rid-ukraine-of-nazis-is-especially-absurd-given-its-history-177959>.

<sup>10</sup> “Denazifikimi sipas Moskës: Do të zgjasë 25 vjet, punë e detyruar, të zhduket emri Ukrainë,” Albanian Post, 4 prill 2022. <https://albanianpost.com/denazifikimi-sipas-moskes-do-te-zgjase-25-vjet-pune-e-detyruar-te-zhduket-emri-ukraine/>.

<sup>11</sup> “Duan të shkatërrojnë Rusinë”, Medvedev: Do të arrijmë qëllimet tona në Ukrainë,” Dosja, 8 gusht 2022. <https://dosja.al/newsmobile//234191/>.



po themelon laboratorë biologjike të rrezikshëm nëpër Ukrainë për të prodhuar armë kimike që do të kenë specifikisht si objekt rusët.<sup>12</sup> Të gjitha këto narrativa e kanë gjetur rrugën e tyre nëpër mediat shqiptare, shpeshherë të publikuara pa sqarime, pa fakte të verifikuara ose pa kontekst.

### **III.2 Përfshirja e NATO-s/Shteteve të Bashkuara në Ukrainë**

Narrativat kundër Perëndimit kanë qenë në thelb të historive që Rusia po tregon lidhur me arsyen e saj për pushtimin e Ukrainës. Zgjerimi i NATO-s në ish Bllokun Lindor dhe mundësia e miratimit të anëtarësimit të Ukrainës në NATO është cituar nga qeveria ruse si motiv për veprimet e saj ushtarake. Në veçanti, Kremli ka përdorur narrativa sipas të cilave NATO ka nisur organizimin e veprimeve ushtarake kundër Rusisë dhe e përshkruan Aleancën si kërcënim ekzistencial për vendin.<sup>13</sup> Narrativa kundër NATO-s ka vazhduar të theksohet përgjatë muajve dhe është përdorur për intensifikimin e veprimeve ushtarake në Ukrainë.

Për më tepër, aparati mediatik rus dhe mbështetësit e tij shpesh e kanë përhapur dezinformimin për përfshirjen e NATO-s në luftë, duke pretenduar se NATO e ka mbështetur Ukrainën në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke dërguar ushtarë në territorin e saj. Deklaratat e qeverive dhe politikanëve perëndimorë për mbështetjen e NATO-s dhe Perëndimit ndaj Ukrainës janë përdorur për të përhapur informacion të pavërtetë, duke

shkaktuar tensione dhe duke bërë kërcënime për përshkallëzim.

Për shembull, në mars të vitit 2024, mediat shqiptare raportuan se ushtarët e NATO-s ishin tashmë në Ukrainë.<sup>14</sup> Kjo bazohet në fjalët e Ministrit të Jashtëm polak Radoslaw Sikorski, të cilat u raportuan nga British Sky News.<sup>15</sup> Mediat pretenduan se Sikorski ka shkaktuar debate duke thënë se personeli ushtarak i NATO-s është tashmë në Ukrainë. Në një deklaratë, Sikorski ka lavdëruar vendet që kishin dërguar ushtarë në Ukrainë pa përmendur detaje. Këto pretendime janë të rrezikshme pasi Rusia ka deklaruar se çdo ndërhyrje nga një shtet anëtar i NATO-s nënkupton luftë me NATO-n.

### **III.3 Rusia do të fillojë Luftën e Tretë Botërore/Luftën Bërthamore**

Një nga narrativat më të përhapura në media shqiptare pas pushtimit të Rusisë në Ukrainë është ajo për fillimin e Luftës së Tretë Botërore, veçanërisht i luftës bërthamore që do të shkatërrojë botën. Duke u bazuar në tabloidet britanike dhe gjermane, si dhe në deklaratat e Kremlinit, mediat shqiptare kanë nxitur frikën për një luftë botërore që nga fillimi i pushtimit. Tituj si “Dosja sekrete gjermane/Plani i Putin për fillimin e Luftës së Tretë Botërore në verën e ardhshme,” janë të zakonshme dhe publikohen rregullisht çdo javë në portale dhe kanale lajmesh shqiptare.<sup>16</sup> Kërcënimet për përdorimin e armëve bërthamore janë prezantuar si të afërta dhe potencialisht

<sup>12</sup> “Rusia akuzon SHBA dhe Ukrainën: Po bashkëpunojnë për armët kimike,” Vizion Plus, 12 mars 2022. <https://www.vizionplus.tv/rusia-akuzon-shba-dhe-ukrainen-po-bashkepunojne-per-armet-kimike/>.

<sup>13</sup> Zofia Stemplowska, “Zgjerimi i NATO-s nuk është fajtor për luftën e Rusisë në Ukrainë,” LSE, 22 prill 2022. <https://blogs.lse.ac.uk/europpblog/2022/04/27/nato-enlargement-is-not-to-blame-for-russias-war-in-ukraine/>.

<sup>14</sup> “Deklarata e fortë e Ministrit të Jashtëm polak: Ushtarët e NATO-s tashmë të pranishëm në Ukrainë,” Lapsi, 11 mars 2024. <https://lapsi.al/2024/03/11/deklarata-e-forte-e-ministrit-te-jashtem-polak-ushtarët-e-nato-s-tashme-te-pranishem-ne-ukraine/>.

<sup>15</sup> “Ushtarët e NATO-s ‘tashmë të pranishëm’ në Ukrainë, thotë ministri i jashtëm polak,” Sky News, 11 mars 2024. <https://news.sky.com/story/russia-ukraine-war-live-updates-putin-election-navy-sky-news-blog-latest-12541713?postId=7367294#liveblog-body>.

<sup>16</sup> “Dosja sekrete gjermane/ Plani i Putin për të nisur Luftën e Tretë Botërore verën e ardhshme,” Lapsi, 15 janar 2024. <https://lapsi.al/2024/01/15/dosja-sekrete-gjermane-plani-i-putin-per-te-nisur-luften-e-trete-boterore-veren-e-ardhshme/>.

të pashmangshme, siç është rasti me titullin, “Bota drejt një luftë bërthamore? Rusia miraton tërheqjen nga traktati për ndalimin e testeve bërthamore.”<sup>17</sup> Këto narrativa, të cilat shkaktojnë emocione dhe rrisin interesin e angazhimit në portale, kontribuojnë në propagandën ruse (për shembull, pretendimet se sanksionet kundër Rusisë nuk po funksionojnë, ose se Rusia po fiton luftën). Ato krijojnë panik në popullatën e gjerë dhe shqetësime që mund t’i shtyjnë njerëzit të ndërhyjnë politikisht për të ndaluar presionin mbi Rusinë. Megjithatë, edhe pse nuk është e pamundur që Rusia të përpiqet në një moment të caktuar të nisë një luftë më të gjerë në rajon ose me NATO-n, narrativave që po përhapen në mediat shqiptare u mungon konteksti dhe janë shpesh të ekzagjeruara.<sup>18</sup>

### **III.4 Luftërat shërbyese nga palë të treta në Ballkanin Perëndimor**

Lidhjet e ngushta midis Rusisë dhe Serbisë, grupimeve të caktuara në Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Bosnjë, e kanë bërë rajonin veçanërisht vulnerabël jo vetëm ndaj dezinformimit, por edhe ndaj interesave strategjike të Rusisë. Ndjenja nacionaliste për Serbinë e Madhe është rritur gjatë viteve dhe është intensifikuar pas pushtimit të Rusisë në Ukrainë, i cili e ka fuqizuar ndjenjën nacionaliste në vende me popullsi të konsiderueshme serbe.

Situata midis Kosovës dhe Serbisë, dhe veçanërisht ngjarjet dhe konfliktet e lidhura me

pjesën veriore të Kosovës, janë bërë shkak i dezinformimit dhe narrativave që përkeqësojnë tensionin, konfliktin, dhe krijojnë ndjenja pasigurie. Narrativat për përshkallëzime të mundshme që do shkaktonin luftë në rajon kanë dalë në pah sa herë që dy qeveritë janë përplasur për çështje traktatesh si kartat e identitetit kombëtar, zgjedhjet, targat e makinave, dhe Asociacioni i Komunave Serbe.


Ato kanë përfshirë edhe lajme që Serbia ka dërguar ushtrinë e saj në kufi për të kryer stërvitje ushtarake, sulme terroriste në Banja Luka, por edhe pretendime nga qeveria serbe se Kosova dëshiron të largojë ose të spastrojë etnikisht të gjithë serbët nga veriu i Kosovës, apo që lobimi shqiptar po paguan opozitën serbe. Në përgjithësi, shumë narrativa kundër Perëndimit dhe teori konspirative mbërrijnë në Shqipëri nga deklaratat e bëra nga qeveria serbe.

Përtej Kosovës dhe Serbisë, shqetësime ka pasur edhe në lidhje me idenë që Rusia do ta përdorë Ballkanin për ta futur rajonin në një luftë shërbyese që përfshin vendet e tij dhe NATO-n. Një shembull që do të shqyrtohet më poshtë në mënyrë më të detajuar janë pretendimet që i atribuohen presidentit ukrainas Volodimir Zelenski ose Departamentit Amerikan të Shtetit sipas të cilave situata në Ballkanin Perëndimor po përkeqësohet ndërsa Rusia po përgatitet të fillojë një luftë shërbyese në rajon. Këto narrativa, si narrivat për një luftë të mundshme bërthamore, lehtësojnë mosmarrëveshjet dhe konfliktet që ndihmojnë projektin global të Rusisë.

<sup>17</sup>. “Bota drejt një lufte nukleare? Rusia miraton tërheqjen nga Traktati i Ndalimit të Provave Bërthamore,” Pamfleti, 19 tetor 2023. <https://www.youtube.com/watch?v=Y2L3byT7hDQ>.

<sup>18</sup>. Mark Toth dhe Jonathan Sweet, “A do të rrezikojë Putin Luftën e Tretë Botërore?,” The Hill, 21 mars 2024. <https://thehill.com/opinion/national-security/4544378-will-putin-risk-world-war-iii/>.

## IV. RASTET STUDIMORE



Këto raste janë përshtatur nga përpjekjet e Faktoje për verifikimin e fakteve kundër dezinformimit rus, duke ndjekur narrativat kryesore që kemi identifikuar në median shqiptare që prej fillimit të luftës.

### RASTI STUDIMORE 1:

#### Mercenarë shqiptarë në Ukrainë<sup>19</sup>

Në qershor të vitit 2022, Ambasada Ruse në Shqipëri publikoi një listë në të cilën njoftoi se 42 mercenarë nga Shqipëria ishin vrarë në Ukrainë, ndërsa pretendonte se rreth 150 mercenarë

shqiptarë kanë qenë të pranishëm në Ukrainë që prej fillimit të luftës.

Top News-42 shqiptarë të vrarë në Ukrainë!/Rusia akuzua ...

Ambasada ruse në Tiranë akuzoi sërish Shqipërinë dhe Kosovën se po dërgojnë mercenarë për të luftuar kundër ushtrisë ruse ...

YouTube · Top Channel Albania · 1 javë më parë

<https://a2news.com> · 2022/05/18 · rusia-150-mercenar... ▾

Rusia: 150 mercenarë nga Shqipëria në Ukrainë ... - A2 CNN

18 qer 2022 — Por Ministria e Jashtme e Shqipërisë i mohoi kategorikisht këto pretendime dhe në shenjë proteste thirrri ambasadorin rus në Tiranë. A2 CNN ...

<https://kohajone.com> · Bota ▾

150 mercenarë shqiptarë në Ukrainë, kemi eliminuar 42

18 qer 2022 — Ambasada ruse në Tiranë: 150 mercenarë shqiptarë në Ukrainë, kemi eliminuar 42 ... Ministria e Mbrojtjes e Rusisë ka publikuar statistikën e plotë ...

<https://www.balkanweb.com> · rusia-nxjerr-shifrat-150... ▾

150 mercenarë shqiptarë i janë bashkuar luftës në Ukrainë ...

Rusia nxjerr shifrat: 150 mercenarë shqiptarë i janë bashkuar luftës në Ukrainë, kemi eliminuar 42 (Tabela). 18 Qershor, 2022 11:19. Serbia Russia ...

Embassy of Russia in Albania / Посольство России в Албани

June 18 at 10:19 AM ·

Ministria e Mbrojtjes e Rusisë ka publikuar statistikën e plotë për mercenarët e huaj që luftojnë në Ukrainë

Lexoni versionin e plotë të dokumentit:  
<https://eng.mil.ru/.../Number%20of%20foreign...>

**NUMBER OF FOREIGN MERCENARIES IN UKRAINE**

| Country                | Arrived since 24.02.22 | Eliminated | Departed | Total on 17.06.22 |
|------------------------|------------------------|------------|----------|-------------------|
| <b>Europe</b>          |                        |            |          |                   |
| Poland                 | 1831                   | 378        | 272      | 1181              |
| Romania                | 504                    | 102        | 98       | 304               |
| United Kingdom         | 422                    | 101        | 95       | 226               |
| Croatia                | 204                    | 74         | 51       | 79                |
| Belarus                | 197                    | 69         | 59       | 69                |
| France                 | 183                    | 59         | 45       | 79                |
| Bosnia and Herzegovina | 167                    | 51         | 46       | 70                |
| Estonia                | 164                    | 55         | 49       | 60                |
| Kosovo                 | 156                    | 61         | 60       | 35                |
| Albania                | 150                    | 42         | 40       | 68                |
| Lithuania              | 130                    | 50         | 44       | 36                |

Kronikë

**Ambasada ruse publikon listën e mercenarëve që luftojnë në Ukrainë: 306 luftëtarë nga Shqipëria dhe Kosova erdhën në Ukrainë, 103 janë vrarë**


Ambasada ruse ka publikuar në faqen e saj zyrtare në Facebook, listën e mercenarëve që kanë shkuar të luftojnë në Ukrainë, kundër Rusisë, që kur nisi agresionin rus, që nga data 24 shkurt e këtij viti

IN UKRAINE

| Country        | Arrived since 24.02.22 | Eliminated | Departed | Total on 17.06.22 |
|----------------|------------------------|------------|----------|-------------------|
| <b>Europe</b>  |                        |            |          |                   |
| Poland         | 1831                   | 378        | 272      | 1181              |
| Romania        | 504                    | 102        | 98       | 304               |
| United Kingdom | 422                    | 101        | 95       | 226               |
| Croatia        | 204                    | 74         | 51       | 79                |
| Belarus        | 197                    | 69         | 59       | 69                |
| France         | 183                    | 59         | 45       | 79                |

<sup>19</sup>. Aimana Vogli, "Debunking/ 42 nga 150 mercenarë shqiptarë janë vrarë në Ukrainë Institucionet zyrtare: Deklarata është e pavërtetë," <https://faktoje.al/debunking-42-nga-150-mercenare-shqiptare-jane-vrare-ne-ukraine-institucionet-zyrtare-deklarata-eshte-e-pavertete/>.

Disa media bashkuan numrin e pretenduar të shqiptarëve nga të dy vendet, Shqipëria dhe Kosova, duke publikuar artikuj ku numri i pretenduar i shqiptarëve të përfshirë në konfliktin Ukrainë-Rusi dukej edhe më i lartë.



Faktoje është përpjekur t'i verifikojë informacionet e publikuara në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes Ruse, duke kërkuar informacion shtesë mbi burimin e këtyre të dhënave, por aksesimi është refuzuar.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e ka mohuar deklaratën e publikuar nga ambasada ruse, teksa rikonfirmonte qëndrimin e bërë publik nga Ministria Xhaçka në mars të vitit 2022, kur u diskutua për herë të parë çështja e mercenarëve shqiptarë në Ukrainë. Në atë kohë, Ministria shkroi: "Nuk ka mercenarë shqiptarë në Ukrainë! Kjo është një gënjeshtëri, që Moskë vazhdon ta përsërisë pa turp! Shqipëria është në anën e Ukrainës dhe do të vazhdojë të punojë me të gjitha aleatët dhe partnerët për të ndihmuar në përfundimin e agresionit të paprovokuar të Rusisë ndaj popullit të Ukrainës. Zoti i bekoftë."



Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë, kontaktuar nga Faktoje, tha: "Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s, qëndron pranë Ukrainës dhe do të mbetet e përkushtuar në përfundimin e konfliktit të armatosur dhe sulmeve të nisura nga Rusia. Si çdo vend anëtar i NATO-s, Shqipëria nuk ka dërguar forca të armatosura në Ukrainë. Sa i përket deklaratave të Ambasadës së Rusisë në Tiranë, ne mbajmë qëndrim të njëjtë si deklarata zyrtare e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për këtë çështje."

Ndërkohë, pak ditë më parë, Kryeministri Edi Rama foli publikisht për këtë listë. Në një konferencë për shtyp në Prishtinë, ai komentoi se pretendimet e Rusisë për përfshirjen e Shqipërisë dhe Kosovës në luftën e Ukrainës nuk janë të reja dhe në fakt janë të qëllimta. Në të kaluarën, Faktoje ka verifikuar deklaratat e ngjashme të Ministrit të Jashtëm të Rusisë, Sergey Lavrov, përfshirë deklaratat të bëra vetëm disa ditë para fillimit të luftës. Deklarata përfshinin edhe pretendime të pavërtetuara për mercenarë nga Shqipëria të përfshirë në konfliktin Rusi-Ukrainë dhe janë pjesë e retorikës dhe propagandës së Rusisë për luftën, të cilën ajo e përdor për të promovuar dezinformimin dhe lajme të rreme.

## **RASTI STUDIMOR 2:**

